



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 5, datë 20.12.2018

MBI

CAKTIMIN ME SHORT TË MANDATIT 3-VJEÇAR TË ANËTARËVE GJYQTARË DHE ANËTARËVE JOGJYQTARË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur për herë të parë, sot më datë 20.12.2018, me pjesëmarrjen e 11 anëtarëve, mbështetur në nenin 179, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas realizimit të procedurës me short sipas rregullave bashkëlidhur këtij vendimi,

V E N D O S I:

- I. Anëtarët gjyqtarë, të cilët do të shërbejnë për një mandat trevjeçar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë:
 1. Z. Medi Bici, nga Gjykata e Lartë;
 2. Z. Ilir Toska, nga gjykatat e apelit;
 3. Znj. Brunilda Kadi, nga gjykatat e shkallës së parë.

- II. Anëtarët jogjyqtarë, të cilët do të shërbejnë për një mandat trevjeçar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë:
 1. Z. Erjon Muharremaj, nga trupa e pedagogëve;
 2. Z. Maksim Qoku, nga trupa e pedagogëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

MBI
RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR PROCEDURËN E CAKTIMIT ME SHORT
PËR TË SHËRBYER PËR NJË MANDAT 3-VJEÇAR TË DY ANËTARËVE
GJYQTARË DHE 2 ANËTARËVE JOGJYQTARË

Caktimi me short për të shërbyer pranë Këshillit për një mandat 3-vjeçar të dy anëtarëve gjyqtarë dhe 2 anëtarëve jogjyqtarë, bëhet sipas rregullores së mëposhtme, e cila parashikon rregullat dhe realizimin e procedurës së gjithë këtij procesi.

1. Për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit dhe dokumentimit të tij ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe stafi administrativ, dhe zhvillohet në mbledhjen e Këshillit Lartë Gjyqësor.
2. Shorti organizohet në 1 kuti/vazo transparente në të cilën vendosen goglat të cilat përmbajnë shiritat e letrës me shënimin “mandat tre vjeçar” dhe “mandat pesë vjeçar”.
3. Hedhja e shortit bëhet sipas procedurës dhe rradhës së mëposhtme:
 - a) **Përzgjedhja e anëtarit nga gjykatat e Apelit** - Në një vazo transparente futen 2 gogla të njëjta, sa është numri i anëtarëve nga gjykatat e apelit. Në njërën prej goglave futet një shirit letre me shënimin “mandate tre vjeçar” dhe në goglën tjetër një shirit letre me shënimin “mandate pesë vjeçar”.
Dy anëtarët e Këshillit që vijnë nga gjykatat e apeleve, tërheqin me rradhë nga një gogël, duke lexuar me zë të lartë dhe duke e treguar para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve tekstin e shkruar në shirit. Teksti i shkruar në letër tregon dhe mandatin që do të ketë ky anëtar i Këshillit.
 - b) **Përzgjedhja e anëtarit nga gjykatat e shkallës së parë** - Në vazoon transparente futen 3 gogla të njëjta, sa është numri i anëtarëve nga gjykatat e shkallës së parë. Në njërën prej goglave futet një shirit letre me shënimin “mandate tre vjeçar” dhe në dy të tjerat shirita letre me shënimin “mandat pesë vjeçar”.
Tre anëtarët e Këshillit që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë, tërheqin me rradhë nga një gogël, duke lexuar me zë të lartë dhe duke e treguar para anëtarëve dhe pjesëmarrësve tekstin e shkruar në shirit. Teksti i shkruar në letër tregon dhe mandatin që do të ketë ky anëtar i Këshillit.
 - c) **Përzgjedhja e dy anëtarëve jogjyqtarë** - Në vazo futen 5 gogla të njëjta, sa është numri i anëtarëve jogjyqtarë. Në dy prej goglave futen, nga një për secilën, shirita letre me shënimin “mandate tre vjeçar” dhe në tre të tjerat shirita letre me shënimin “mandate pesë vjeçar”.
Pesë anëtarët e Këshillit jogjyqtarë, tërheqin me rradhë nga një gogël, duke lexuar me zë të lartë dhe duke e treguar para anëtarëve dhe pjesëmarrësve tekstin e shkruar në shirit. Teksti i shkruar në letër tregon dhe mandatin që do të ketë ky anëtar i Këshillit.

4. Në përfundim të procesit të shortimit Kryetari i Këshillit shpall listën e anëtarëve të Këshillit me mandatet përkatëse.
5. Dokumentimi i çdo faze të procedurës së organizimit dhe hedhjes së shortit sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje bëhet në procesverbal dhe në sistemin e regjistrimit audio.